GSK-KPA-A-036/16

GJYKATA SUPREME E KOSOVËS, bazuar në nenin 16 të Ligjit nr.03/L-079, për ndryshimin e Rregullores së UNMIK-ut,nr.2006/50, për zgjidhjen e kërkesave lidhur me pronën e paluajtshme private duke përfshirë pronën Bujqësore dhe ate Komerciale, kolegji në përbërje nga gjyqtarët, Beshir Islami kryetar i kolegjit, Ragip Namani dhe Jelena Krivokapić, gjyqtar, me pjesëmarrjen e bashkëpunëtorit profesional Sherif Krasniqi, në çështjen juridike **të palës ankuese;**

I. A., .Smederevo, Srbija

Kundër:

Gj. A. dhe H. A., nga K. Viti

Palë përgjegjëse

Duke vendosur lidhur me ankesën e paraqitur, kundër Vendimit të Komisionit për Kërkesa Pronësore të Kosovës KPPC/D/A/260/2014, të datës 21 Tetor 2014,(lënda e regjistruar në AKP me numër KPA45343), pas shqyrtimit të mbajtur me datë, 21 Gusht 2019, merr;

AKTGJYKIM

1. **Refuzohet si e pabazuar Ankesa e parashtruar I. A., paraqitur kundër Vendimit KPCC/D/A/260/2014, të datës 21 Tetor 2014, (lënda e regjistruar në AKP me numër KPA45343).**

2. **Vërtetohet Vendimi i Komisionit për Kërkesa Pronësore të Kosovës KPCC/D/A/260/2014, i datës 21 Tetor 2014.**

<u>Përmbledhje e çështjeve procedurale dhe faktike:</u>

1. Më 05 Nëntor 2007, I. T. A. (tani e tutje; parashtruesi i ankesës), ka paraqitur kërkesë në Agjencinë Kosovare të Pronës (tani e tutje: AKP), në cilësinë e anëtarit të bashkësisë familjare të babait të tij të ndjerë T. A., si bartës i së drejtës pronësore. Ai fillimisht e cek se babai i tij i ndjerë ishte pronar i ngastrës kadastrale nr..., me kulturë shtëpi-ndërtesë, oborr dhe arë e kl. të tretë, në sipërfaqe të përgjithshme prej 0.06.76ha. Thekson se në këtë ngastër ka ekzistuar shtëpia përdhese me sipërfaqe prej 105m2 me garazh dhe kuzhinë verore të cilat të gjitha janë rrënuar gjatë vitit 1999. Si dëshmi e paraqet Fletën Poseduese nr. ..., Komuna Kadastrale ..., K. Viti. Po ashtu thekson se pas vdekjes së babait të tij është rregulluar trashëgimia por ndryshimet pronësore në operatin kadastral nuk janë kryer.

2. Në vitin 2011 pala ankuese Agjencinë Kosovare të Pronave e informon se kërkesa e tij fillestare e paraqitur në AKP, lidhur me ngastrën e kërkuar kadastrale nr. ..., ka qen gabim dhe konfirmon se këtë ngastër e kanë shitur. Pas sqarimit me sekretarin tani thekson se kërkesën e paraqet për dy ngastra tjera dhe ate ngastrën kad. nr. ..., dhe ..., të cilat gjenden po ashtu në Komunën Kadstrale ..., të cilat nuk i përmban fleta poseduese ..., por në bazë të Aktgjykimit të gjykatës nr.112/75.

3. Në kadastër sekretaria kishte gjetur se ngastra kad. 848 ishte e ndarë në ngastra kadastrale nr. ..., nr. ...,dhe nr. ..., dhe në bazë të sipërfaqes së kërkuar nga pala kërkuese 0.03.41ha., është arrit të saktësohet se kërkesa ka të bëjë me ngastrën **kad....,** në sipërfaqe prej 0.03.61ha., **dhe ngastrën kadastrale nr. ...,** në sipërfaqe të pjesshme prej 0.08.50ha, të dyja në sipërfaqe të përgjithshme prej **0.12.11ha.**

4. Në deklaratën e tij pala ankuese ka theksuar se të drejtën pronësore babai i tij në pronën e kërkuar e ka fituar në bazë të blerjes, ndërsa posedimin e pronës së kërkuar e ka humbur si pasojë e rrethanave që ndërlidhen me konfliktin në Kosovë, të ndodhur në vitet 1998/99, si datë të humbjes e cek datën 12 Qershor 1999, andaj kërkon ri posedimin e së njëjtës me që e njëjta është e uzurpuar.

5. Së bashku me kërkesën, në AKP, ka dorëzuar dokumentet si në vijim;
    - Aktgjykimin e Gjykatës C. nr.112/75, të dt. 04.11.1975, i nxjerrë në bazë të pranimit ku paditës ishte babai i palës ankuese T. A., ndërsa palë e paditur si shitës ishte B. D., sipas të cilit babait të palës ankuese i ishte njohur pronësia në ngastrat kadastrale nr. ., në sipërfaqe prej 0.03.41ha., dhe ngastrën kadastrale nr. ..., në sipërfaqe të pjesëshme prej 0.08.50ha., (ky dokument nuk është gjendur në gjykatën vendore kompetente).
    - Vendimin e Trashëgimisë, Nr. O.nr.41/93, të dt. 29.10.1993, që e paraqet palën ankuese si trashëgimtar nga babai i tij me ¾, pjesë ideale, dhe nënën e tij me ¼ pjesë ideale të paluajtshmërive , (por ngastrat e kërkuara sipas kërkesës së palës ankuese nuk janë të përfshira në këtë vendim të trashëgimisë.
    - Vendimin kadastral të shërbimit kadastral të Serbisë nr. ..., të dt. 24.06.1998, me të cilin kadastri ka lejuar ndryshimet Kadastrale lidhur me fletën poseduese ..., të disa ngastrave, (por nuk i përmban ngastrat e kërkuara).
    - Certifikatën e vdekjes nr...., të dt. 30.07.2001,me të cilin konfirmohet vdekja e bartësit të drejtës pronësore, babait të tij T. A., në Gjilan me datë 23.09.1993.

6. Njoftimi i kërkesës fillestare për pronën e kërkuar, ngastrën kad. ..., dhe notifikimi fizik nga ekipi i njoftimit të AKP-së, është bërë më 08.05.2008, e njëjta është gjet pronë jo e uzurpuar. Gj. A.(PP1) është paraqit në AKP në vitin 2011 ka kërkuar të drejtë ligjore në ngastrën kad. ..., i njëjti ka paraqitur dy kontrata të shitblerjes të vitit 1994 të cilat paraqesin

një transaksion jo formal të një sipërfaqe prej 07 ari, ndërmjet BDP të pretenduar dhe atij si palë përgjegjëse PP1.

7. Notifikimi dhe njoftimi i ngastrave të kërkuara me kërkesë plotësuese nr. ... dhe ... ishte bërë duke u publikuar për mes gazetës së publikimeve të dt. 25.04.2013, nga vizita në teren me datë 04.09.2014, H. A. (PP2), është gjendur se është duke i shfrytëzuar pronat e kërkuara, i cili ka kërkuar të drejtë ligjore. I njëjti pretendon se familja e tij para 20 vite e kanë blerë nga shitësi i parë B. D.a, po ashtu deklaron se të drejtën e tij mund ta dëshmoj me aktgjykim të gjykatës dhe Fletën poseduese, të cilat megjithatë nuk i ka ofruar.

8. Sekretaria e AKP-së gjatë hetimeve *ex offcio,* në të dhënat kadastrale dhe historikun e pronës së kërkuar ka gjetur se kjo pronë gjatë periudhës 1983-1988, në kadastër ka qen e regjistruar në emër të shitësit të parë B. D..

9. Po ashtu sekretaria e AKP-së, *ex officio* kishte vërtetuar se tri kërkesa të paraqitura nga pala ankuese për prona të tjera, nga KKPK janë shqyrtuar dhe vendosur në favor të tij si jo kontestuese, pasi që dokumentet e ofruara nga ai janë vlerësuar si dëshmi të vlefshme pronësore në bazë të cilave është dëshmuar pronësia e tijë. Po ashtu është konfirmuar se në bazë të dhënave në HPD, kërkesa e kategorisë "C", e palës ankuese DS 602007, për pronë tjetër ngastrën kad. ..., ishte miratuar nga Komisioni për çështje banesore pronësore sipas vendimit të saj, nr. HPCC/D/147/C të dt. 2708.2004.

10. I kontaktuar nga sekretaria pala ankuese ka ripërsëritur se nuk e kërkon ngastrën kadastrale ..., sepse kjo i është shit nga xhaxhai i tij palës përgjegjëse një,(PP1) Gj. A. Ai ka deklaruar se i kërkon ngastrat ... dhe ..., të cilat nga babai i tij janë blerë nga shitësi i parë B. D., në vitin 1975 në bazë të aktgjykimit C.112/75, .në të cilën pronë familja e tij kanë ndërtuar shtëpi dhe kanë jetuar gjer në Qershor 1999, kur janë zhvendosur nga Kosova. Po ashtu e pranon se vëllai i palës përgjegjëse nr. 2 (PP2), e ka blerë sipërfaqen prej 02 ari, të ngastrës kad. ..., nga shitësi i parë B.D.

11. Pala përgjegjëse nr. 2.,(PP2), H. A., kishte deklaruar se vëllai i tij dhe ai e kishin blerë pronën kontestuese para 20 vitesh nga shitësi i parë B. D., i njëjti thekson se e posedon aktgjykimin e gjykatës vendore me të cilin i njihet e drejta pronësore vëllait të tij në pronën e kërkuar.

12. Sekretaria e AKP-së Aktgjykimin në të cilin e bazon të drejtën e tij pala ankuese, C nr.112/75 ,nuk kishte arritur që ta verifikoj pozitivisht, sepse ky dokument nuk ishte gjetur në gjykatën vendore në Viti. Po ashtu në bazë të shënimeve Kadastrale të periudhës 1983-1988, ngastrat e kërkuara janë gjetur të evidentuara në emër të pronarit të parë B. D.

13. Megjithatë sekretari ka gjetur *ex officio,* një aktgjykim të vitit 2008, C.nr. 252/2000, të dt. 25.01.2008, në bazë të cilit vërtetohet se vëllait të palës përgjegjëse nr. 2. S. A., i ishte njohur

e drejta pronësore në pronën e kërkuar ngastrën kad. ... dhe ngastrën kad. ... Po ashtu në kadastër sipas Certifikatës së të Drejtave Pronësore (CDP) Ul.70101033-..., të dt. 20.09.2012, prona e kërkuar evidentohet në emër të S. A.

14. Me Vendimin KPCC/D/A/260/2014, të datës 21 Tetor 2014, Komisioni për Kërkesa Pronësore të Kosovës (tani e tutje: KKPK), e ka refuzuar kërkesën e palës ankuese. Në arsyetimin e Vendimit grupor në paragrafin 44 , theksohet se paraqitësi i kërkesës në mbështetje të kërkesës së tij ka dështuar të paraqes dëshmi për të drejtën pronësore që do të mund të verifikohej nga sekretaria ekzekutive e AKP-së, që bartësi i pretenduar i të drejtës pronësore gëzon të drejtë pronësore mbi pronën e kërkuar, as sekretaria ekzekutive *ex officio* nuk ka arritur për të siguruar asnjë dëshmi të tillë. Komisioni bazuar në dëshmitë para tij arrin në përfundimin se paraqitësi i kërkesës ka dështuar të dëshmoj të drejtën e tij pronësore, ose çfarë do të drejte tjetër pronësore për pronën e kërkuar, menjëherë, para, ose gjatë konfliktit të viteve 1998-99, andaj rrjedhimisht kërkesa duhet refuzuar.

15. Me datë 19 Mars 2015, Vendimi i KKPK-së i ishte dorëzuar palës ankuese I. A. Me datë 10 Prill 2015, i njëjti ka ushtruar ankesë kundër tij.

16. Me datë 13. 02. 2015 Vendimi i KKPK-së i ishte dorëzuar palës përgjegjëse Gj. A., ndërsa me datë 11.02.2015, palës përgjegjëse H. A.

17. Me datë 05.01.2018, kopja e ankesës së palës ankuese I. A., i është dorëzuar palës përgjegjëse H. A. për paraqitjen e përgjigjes në ankesë. Në shkresa të lëndës nuk ka prova se ka paraqitur përgjigje në ankesë.

18. Pala përgjegjëse Gj. A., pas marrjes së vendimit të KKPK në përgjigjen e tij ndër të tjera ka theksuar se nuk ka kurrfarë lidhje me këtë lëndë për shkak se asnjëherë nuk ka qen në posedim të pronës së kërkuar.(të ngastrave kad. ... ,dhe ..., në sipërfaqe të përgjithshme prej 0.12.11ha.), dhe as që ka lidhje me këtë pronë, vlerëson se është bërë një gabim nga vet paraqitësi i kërkesës, apo AKP-ja, kur ky përmendet si palë në këtë lëndë.

<u>Pretendimet e palës ankuese</u>

19. Pala ankuese I. A. vendimin e KKPK-së, e atakon për shkak të, vërtetimit të gabuar dhe jo të plotë të gjendjes faktike, dhe zbatimit të gabuar të drejtës materiale.

20. Në arsyetimin e ankesës pasi e përshkruan mënyrën e vendosjes si në vendimin e KKPK-së ndër të tjera thekson se; së pari nuk është e qartë a refuzohet kërkesa e tij apo hedhet poshtë, sepse në dispozitiv të vendimit është shkruar që kërkesa hedhet, ndërsa në arsyetimin e tij se kërkesa refuzohet, se nuk janë të qëndrueshme theksimet në vendimin e ankimuar se pala ankuese nuk ka ofruar prova të cilat kanë mundur të verifikohen pozitivisht për tu

dëshmuar e drejta pronësore, sepse ka ofruar prova që babai i tij T. A., e ka fituar pronësinë në pronën lëndore sipas Aktgjykimit të Gjykatës Komunale në Viti nr. P-112/75, dt. 04.11.1975, tutje i thekson dëshmitë e tjera që i ka paraqitur më parë në AKP të cilat janë shqyrtuar, andaj në bazë të tyre vlerëson se ka qen posedues i ligjshëm i pronës së kërkuar të cilën thekson se e ka uzurpuar H. A. e jo G. A. i cili e ka blerë ngastrën ... nga xhaxhai i tij më herët, se me mënyrën e vendosjes si në vendimin e KKPK-së, i janë cenuar të drejtat e tij pronësore të cilat mbrohen me kushtetutë me konventë dhe akte të tjera ndërkombëtare, të cekura si në ankesë etj.

21. Në fund propozon që Gjykata Supreme e Kosovës, me miratimin e ankesës së tij të nxjerrë vendim me të cilin në tërësi aprovohet kërkesa e tij dhe të vërtetohet që i takon e drejta e pronësisë në pronën lëndore ngastrat kad. nr..., dhe ..., në sipërfaqe prej 0.12.11ha., sipas fletës poseduese nr. ..., Komuna Kadastrale ..., Komuna Viti.

<u>Pranueshmëria e ankesës</u>

22. Ankesa është e pranueshme sepse është paraqitur brenda periudhës prej 30 ditë nga dita e pranimit të Vendimit të KKPK, siç është paraparë me nenin 12.1 të Rregullores së UNMIK-ut 2006/50, e ndryshuar me Ligjin nr. 03/L-079, për zgjidhjen e kërkesave lidhur me Pronën e Paluajtshme Private, duke përfshirë Pronën Bujqësore dhe atë Komerciale.

23. Ankesa u shqyrtua në kuptim të nenit 194 të Ligjit Nr. 03/L-006, mbi Procedurën Kontestimore, (Gaz. Zyrtare e Republikës së Kosovës Nr.38/2008), (në tekstin e mëtejmë LPK), dhe pas shqyrtimit të aktgjykimit sipas pretendimeve në ankesë dhe sipas detyrës zyrtare gjen se, ankesa është e pa bazuar.

<u>Arsyetimi ligjor</u>

Juridiksioni

24. Sipas nenit 3.1 të Rregullores së UNMIK nr.2006/50 e ndryshuar me Ligjin nr. 03/L-079, paraqitësi i kërkesës ka të drejtë në një urdhër të Komisionit për ri posedimin e pronës së kërkuar ,nëse paraqitësi i kërkesës jo vetëm që duhet të dëshmoj të drejtën e tij pronësore mbi pronën e pa luajtshme private ,por gjithashtu duhet të dëshmoj që ai ose ajo tani nuk është në gjendje ta ushtroj këtë të drejtë pronësore për shkak të rrethanave që lidhen drejtpërdrejtë me ose që rezultojnë nga konflikti i armatosur i cili ka ndodhur në Kosovë ,ndërmjet 27 Shkurt 1998 dhe 20 Qershor 1999.

25. Duke u nisur sipas pretendimeve në ankesë dhe ekzaminimit edhe *ex officio* të Vendimit, në këtë lëndë është e nevojshme të përcaktohet , nëse pala ankuese ka paraqitur prova se babai tij i ndjerë, familjarët i tij, apo pas vdekjes së babait pala ankuese, a posedon dhe a ka paraqitur prova se ka qen pronar ligjor i pronës së kërkuar për të vërtetuar të drejtën e tij

pronësore, dhe pastaj për tu vërtetuar se kjo pronë është humbur si pasojë e rrethanave të konfliktit në Kosovë të viteve 1998/99, prandaj gjykata Supreme do të fokusohet dhe do të jap përmbledhje dhe sqarime lidhur me këtë çështje në këtë drejtim.

26. Sipas KKPK-së, si në vendimin e saj, pretendimeve në kërkesë dhe në ankesë të palës ankuese, vërtetohet se pala ankuese të drejtën e tij pronësore në pronën e kërkuar e mbështetë në Aktgjykimin në bazë të pranimit, C.nr.112/75, të dt. 04.11.1975, në bazë të cilit pretendon se babai i tij T. A., është bërë pronarë i pronës së kërkuar të cilën e ka blerë më herët nga pala shitëse B. D. në bazë të kontratës jo formale.

27. Megjithatë së pari është fakt se ky dokument i paraqitur nga pala ankuese, nga sekretaria e ekzekutive e AKP-së, nuk është arrit të verifikohet pozitivisht, si ekzistues në arkivin e gjykatës kompetente. Po ashtu ky organ, as *ex officio,* nuk ka arrit të siguroj asnjë provë tjetër në mbështetje të pretendimeve të palës ankuese, gjer sa në organin kompetent kadastral në Viti sekretaria ka gjetur se prona e kërkuar në bazë të shënimeve kadastrale të periudhës 1983-1988, ishte e regjistruar në emër të pronarit të parë B. D., për më tepër edhe gjatë periudhës së viteve 1998/99, e as më pas kjo pronë nuk ka qen e regjistruar në emër të familjarit-babai të tij apo palës ankuese.

28. Nga gjendja konkrete e çështjes si më lartë, në rastet kur e drejta e pronësisë fitohet nga veprimi juridik (bartje ligjore), ashtu si parashihet në nenin 33 të Ligjit për Marrëdhëniet Themelore Juridike, me këtë dispozitë ligjore përcaktohet se në bazë të veprimit juridik, (që në këtë rast konkret është Aktgjykimi C.nr.112/75, i dt. 04.11.1975), e drejta e pronësisë mbi pasurinë e pa luajtshme fitohet me regjistrimin në librin publik,(librin kadastral), ose në mënyrën tjetër përkatëse të përcaktuar me ligj.

29. Gjykata Supreme vlerëson se, nuk provohet me asnjë fakt se Aktgjykimi gjyqësor i Gjykatës Komunale në Viti, në bazë të cilit pretendon se babai i tije është bërë pronar i pronës së kërkuar, ishte ekzekutuar ndonjëherë duke u azhuruar në Operatin Kadastral në Kosovë-Viti, në emër të prindit të tij edhe pse nuk ka pas pengesa juridike apo rrethana të tjera praktike për tu regjistruar-azhuruar prona në emër të tij si blerës, duke pasur parasysh se e Aktgjykimi ishte i nxjerrë në vitin 1975. Andaj paraqitësi i kërkesës ka dështuar të dëshmoj të drejtën pronësore në emër të tij duke e regjistruar në kadastër.

30. Fleta poseduese e paraqitura nga pala ankuese nr. 242, e dt. 31.08.2001,po ashtu me numër të njëjtë e dt. 26.05.2008, të cilat i cek edhe në ankesë dhe në bazë të tyre kërkon ti njihet e drejta në pronën e kërkuar ,nuk e paraqesin(nuk e përmbajnë) pronën e kërkuar por prona tjera. Sipas tyre vërtetohet se babai i palës ankuese është bashkëpronar me ½, i pronave-ngastrave të evidentuara në këto Fleta Poseduese.

31. Theksimet e palës ankuese në ankesë ndër të tjera se, provat e paraqitura nga ai e në veçanti Aktgjykimi nuk është marrë parasysh dhe nuk është shqyrtuar në mënyrë serioze nga KKPK-ja, se ai me familjen e tij kanë jetuar në pronën e kërkuar deri në Qershor 1999,etj, kolegji i vlerëson si jo të bazuara jo të qëndrueshme apo me ndikim për të vendosur ndryshe çështjen, sepse aktgjykimi të cilin e ofron si provë nuk është arrit të verifikohet ekzistues në gjykatën kompetente ndërsa pala ankuese nuk ofron asnjë provë të re valide apo dokument valid kadastral në bazë të cilit do të dëshmohej e drejta pronësore para periudhës së konfliktit të viteve 1998/99, andaj nga këto fakte konstatohet se nuk ka prova të fitimit të pronësisë në mënyrë ligjore, ashtu si u cek edhe më lartë dhe si parashihet sipas kushteve nga neni 20 dhe 33 të Ligjit për Mardhënijet Pronësore Juridike. Nga kjo gjendje e fakteve të cekura si më lartë, realisht dëshmohet se ankesa duhet të refuzohet si e pabazuar, sepse nuk provohet se pronën e kërkuar e ka pas në pronësi në mënyrë ligjore në periudhën kohore , para, menjëherë, ose gjatë konfliktit në vitet 1998-99.

32. Prandaj Gjykata Supreme vlerëson se Vendimi i kundërshtuar i KKPK-së, është marrë me vërtetim të plotë dhe të drejtë të gjendjes faktike dhe mbi këtë bazë edhe ligji material edhe ai procedural janë zbatuar në mënyrën e duhur, me mënyrën e vendosjes duke e refuzuar kërkesën për shkak të mos mbështetjes në dëshmi relevante dhe valide.

33. Sa i përket pretendimit në ankesë se Vendimi i goditur është i pa qartë, dispozitivi i tij në kundërshtim me arsyetimin, nuk dihet se kërkesa e tij është hedhur apo është refuzuar sepse në dispozitiv shkruan se kërkesa e tij është hedhur ndërsa në arsyetim se kërkesa e tij është refuzuar, Gjykata gjatë shqyrtimit të këtij pretendimi gjen se, Vendimi individual që i referohej kërkesës me numër KPA45343, ishte i përfshirë me gabim gjuhësor por që ky gabim nuk ndikon në përmbajtjen e qështjes së vendosur. Në vendimin individual në gjuhën serbe thuhet se kërkesa ishte "*hedhur*", kurse në vendimin grupor në të trija gjuhët zyrtare në përdorim dhe si në paragrafin 44 të këtij vendimi, që aplikohet nëmënyrë specifike për kërkesën e po ashtu në vendimin individual në versionet në gjuhën shqipe dhe angleze thuhet se kërkesa ishte "*refuzuar*".

34. Sipas dispozitave materiale përcaktohet se në rast mospajtimi apo ndryshimi në mes të versionit në gjuhë angleze dhe versionit në gjuhët e tjera, versioni në gjuhë angleze mbizotëron, bazuar në nenin 3.3, të Urdhëresës Administrative nr. 2007/5, për implementimin e Rregullores së UNMIK-ut nr. 2006/50, mbi zgjidhjen e kërkesave lidhur me pronën e paluajtshme private, përfshirë pronat bujqësore dhe ato komerciale, të ndryshuar me Ligjin 03/L-079, ku parashihet se, "*Kurdo që paraqitet ndonjë dallim apo papajtueshmëri në lidhje me ndonjë fjalë, frazë apo interpretim ndërmjet verzionit në gjuhën angleze të dokumentit apo vendimit karshi verzionit në gjuhën shqipe apo serbe, fjala, fraza apo interpretimi në gjuhën angleze do të mbizotërojë dhe do të përdoret*".

35. Prandaj me që vendimi burimor grupor me arsyetim në të trija gjuhët, dhe ai individual në gjuhë burimore angleze dhe gjuhë shqipe figuron se "refuzohet kërkesa", kolegji vlerëson se nuk është me ndikim përmbajtjesor gabimi gjuhësor në vendimin indivudal në gjuhën serbe, sepse duhet të jetë, "kërkesa refuzohet ", si është në vendimin grupor në të tri gjuhet e jo "kërkesa hedhet", sepse interpretimimi dhe verzioni në gjuhë angleze mbizotëron si origjiner dhe si i tillë përdoret.

36. Ky aktgjykim nuk paragjykon ndonjë të drejtë pronësore për palët, e as që paraqet pengesë për inicimin e procedurës pranë organit kompetent apo gjykatës kompetente, për tu shqyrtuar çështja pronësore në baza ligjore nëse palët e gjejnë me interes ligjor.

37. Në bazë të asaj që u tha më lart dhe në përputhje me nenin 13.3 (c), të Ligjit 03/L-079, u vendos si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

<u>Këshillë ligjore;</u>

Në përputhje me nenin 13.6 të Rregullores së UNMIK-ut, nr. 2006/50, e ndryshuar me Ligjin 03/L-079, ky aktgjykim është i plotfuqishëm, nuk mund të kundërshtohet përmes mjeteve të rregullta apo të jashtëzakonshme juridike.

GJYKATA SUPREME E KOSOVËS NË PRISHTINË

GSK-KPA-A-036-2016, me datë 21 Gusht 2019

Bashkp. Profesional, **Kryetari i Kolegjit,**

Sherif Krasniqi **Beshir Islami**